

AKT THEMELIMI
dhe
STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PVAPE" Sh.p.k.

KAPITULLI I
EMRI, FORMA E SHOQËRISE, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Neni 1
Themelimi

- 1.1 Emri i shoqërisë është **"PVAPE"** Sh.p.k (këtu më poshtë e quajtur **"Shoqëria"**). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("**QKB**").
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2
Sella

- 2.1 Sella e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Rruga Dervish Hima, Ndërtesa Ambasador 3, Apt. 125, Tiranë, Shqipëri".
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3
Objekti

- 3.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të jetë:
 - Import, eksport dhe tregtim me shumicë ose pakicë i të gjithë gamës së produkteve të duhanit, si, por pa u kufizuar, cigare elektronike dhe me ngrohje (e-cigarettes, vape etc.), cigare në pako ose paketa, puro, cigarillo, duhan pa tym, për nuhatje, përdorim oral, nargjile, si dhe substanca shtesë, enë rimbushëse, aromatizues, pjesë zëvendësuese për cigare elektronike, me ngrohje dhe të tjera, si dhe importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë ose pakicë të çdo malli tjetër që ka lidhje me produktet e duhanit;
 - Aktivitete promovimi, marketingu, publiciteti të produkteve të duhanit brenda parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm;
 - Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.



- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.
- 3.3 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT

Neni 5


Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 500.000 (pesë qind mijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota.
- 5.2 Ortakët themelues të Shoqërisë janë:
1. **Z. Alessio Jashari**, atësia Ilir, shtetas Shqiptar, lindur në Pisticci, Matera, Itali më 26.10.2002, banues në adresën "Admiral Abdi Mati 00690023; Rruga Gregor Durraku, Nd. 6; H. 19; Ap. 2; Durrës, Shqipëri", mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal K21026051D, zotërues i një kuote me vlerë 250.000 (dy qind e pesëdhjetë mijë) lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë;
 2. **Z. Ejlor Rryta**, atësia Shkëlqim, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri më 22.09.1991, banues në adresën "Rruga Vaçe Zela; Nd. 17; H. 1; ; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, Shqipëri", mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J10922050V, zotërues i një kuote me vlerë 250.000 (dy qind e pesëdhjetë mijë) lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- 5.3 Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 6

Transferimi i Kuotave

- 6.1 Secili Ortak mund të transferojë kuotën e tij çdo pale të tretë, me kusht që Ortaku transferues të ketë njoftuar më parë me shkrim Ortakun tjetër të paktën 3 (tre) muaj para ("Periudha e Njoftimit") mbi numrin e kuotave për t'u shitur, çmimin e shitjes, identifikimin e palës së tretë



dhe çdo kusht tjetër lidhur me transferimin e kuotës. Ortaku tjetër duhet t'i përgjigjet njoftimit të Ortakut transferues nëse dëshiron të blejë kuotën sipas kushteve të vendosura në njoftim brenda Periudhës së Njoftimit. Në rast të një përgjigje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Ortaku transferues mund të procedojë me transferimin e kuotës tek pala e tretë.

KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 7

Asambleja e Përgjithshme

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratori/ët;
 - Emëron dhe shkarkon administratorin/ët;
 - Emëron dhe shkarkon ekspertin (ët) kontabël dhe/ose likuiduesin (t) e Shoqërisë;
 - Përcakton shpërblimin e administratorit/ëve, ekspertit/ëve kontabël dhe likuiduesit/ve;
 - Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori/ët;
 - Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti;
 - Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
 - Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
 - Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 8

Mënyrat e Thirrjes, Përfaqësimi dhe Procesverbali i Mbledhjes

8.1 Mënyrat e Thirrjes

- 8.1.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori në rastet e parashikuar në ligj sa herë që konsiderohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë si dhe nga ortakët e pakicës të cilët zotërojnë të paktën 5% të kapitalit. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit.
- 8.1.2 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të bëhet me shkresë, të dërguar në adresën e ortakëve, ose me postë elektronike në adresën elektronike të ortakëve, të njoftuara Shoqërisë nga ortakët, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.




- 8.1.3 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë informacion mbi rendin e ditës si dhe vendin, orën dhe datën e mbledhjes.
- 8.1.4 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes si më sipër, me kusht që të gjithë ortakët e Shoqërisë të shprehin dakord për të marrë vendime.
- 8.1.5 Në rast se ortakët pjesëmarrës ndodhen në vende të ndryshme, Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet nëpërmjet telekonferencës ose video konferencës ose çdo mjeti tjetër të telekomunikimit, me kusht që këta të fundit të jenë të identifikueshëm dhe të jenë në gjendje të ndjekin diskutimet, në mënyrë që të marrin pjesë dhe të shkëmbejnë dokumente.
- 8.2 Përfaqësimi**
- 8.2.1 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një ortak tjetër apo nga një person tjetër në bazë të një prokure me shkrim. Në çdo rast, prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe është e vlefshme për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 8.2.2 Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 8.3 Procesverbali i Mbledhjes**
- 8.3.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal i cili duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit si dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e ortakëve pjesëmarrës si dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.3.2 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Kryetari i zgjedhur i cili nënshkruan procesverbalin së bashku me mbajtësin e procesverbalit.
- 8.3.3 Administratori i Shoqërisë është përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit.
- 8.3.4 Në rast se Shoqëria ka publikuar një faqe të internetit, Administratori, jo më vonë se 15 ditë nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, është i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit në këtë faqe interneti.

Neni 9

Kuorumi dhe Shumica

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme për çështje të cilat vendosen me shumicë të thjeshtë vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme, për çështje të cilat vendosen me shumicë të kualifikuar prej 3/4, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se 50 % e ortakëve me të drejtë vote dhe votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.



- 9.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së këtij kuorumi, Asambleja duhet të mbledhet përsëri, me të njëjtin rend dite, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas thirrjes së parë.
- 9.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me 3/4 për çështjet e mëposhtme:
- (i) Ndryshime të Statutit;
 - (ii) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - (iii) Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - (iv) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë për çështjet e mëposhtme:
- (i) Përcaktimin e politikave tregtare;
 - (ii) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - (iii) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - (iv) Çdo çështje tjetër të parashikuara shprehimisht nga ligji dhe ky Statut.

Neni 10


Administratori

- 10.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:
- **Z. Alessio Jashari**, atësia Ilir, shtetas Shqiptar, lindur në Pisticci, Matera, Itali më 26.10.2002, banues në adresën "Admiral Abdi Mati 00690023; Rruga Gregor Durrsaku, Nd. 6; H. 19; Ap. 2; Durrës, Shqipëri", mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal K21026051D.
- 10.3 Mandati i administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, i ripërtërishëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 10.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.
- 10.5 *Administratori i parë i Shoqërisë si më sipër autorizohet për të kryer regjistrimin fillestar të Shoqërisë pranë QKB nëpërmjet portalit e-albania, personalisht ose nëpërmjet palëve të treta të autorizuar prej tij.*

Neni 11

Kompetencat e Administratorit

- 11.1 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin e Administratorit, Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administron veprimtarinë e Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve;
 - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;



- Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
 - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe balanceve të konsoliduar, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - Krijimin e sistemit të paralajmërimit në lidhje me rrethanat, të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë;
 - Dorëzimin në QKB të dokumenteve dhe të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
 - Raportimin tek Asambleja e Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
 - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 11.2 Administratori mund të autorizojë palë të treta që të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 11.3 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 12


Viti Financiar

- 12.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 12.2 Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2023.

Neni 13

Shpërndarja e Fitimeve

- 13.1 Pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të këtyre të fundit.



KAPITULLI V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Ligji i Zbatueshëm


- 14.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

Neni 15
Të ndryshme


- 15.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut është nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në shqip.

ORTAKËT E SHOQËRISË "PVAPE" sh.p.k.

ALESSIO JASHARI

Handwritten signature of Alessio Jashari in blue ink, written over a horizontal line.

EJLOR RRYTA

Handwritten signature of Ejlor Rryta in blue ink, written over a horizontal line.

Tiranë më 08.08.2023